

Data 29.6.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Paketa e ndërhyrjeve për rigjenerimin urban në Rajonin 2, Loti 1: Ndërhyrje për rigjenerimin urban, mbrojtje detare në zonën bregdetare: Furnizim vendosje struktura druri dhe tabela për infrastrukturën në plazhe publike, Durrës.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44212320-8

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 6,486,000 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlera e përllëgaritur të kontratës në procedurën e prokurimit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **(2023, 2024, 2025)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/ ctë VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njërive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më te vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës në procedurën e prokurimit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin, natyrën, sasitë dhe vlerën e kontratës. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme për furnizime të ngjashme me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit** nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me kontratë pune (te vlefshme), diplome/certifikate të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/organe/institute të akredituar ku nga këta të jenë të paktën:

- Marangoz	2 (dy)	punonjës
- Hidraulik	1 (një)	punonjës
- Inxhinier Gjeodet	1 (një)	punonjës
- Shofer	1 (një)	punonjës
- Saldator	1 (një)	punonjës

* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti*

kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë staf të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për stafin teknik minimal justifikohet nga natyra e objektit të prokurimit, i cili konsiston kryesisht në transportin, montimin dhe instalimin në terren të strukturave të gatshme (pasarela, kabina, dushe, kulla vrojtimi dhe tabela informuese), në kushte specifike të terrenit ranor. Për realizimin korrekt dhe në kohë të këtij procesi, është e domosdoshme prania e një stafi të kualifikuar, si më poshtë:

-Marangozët (2) janë të nevojshëm për montimin dhe instalimin e strukturave prej druri në terren, përfshirë lidhjen e elementeve modulare dhe garantimin e stabilitetit të tyre në rërë.

-Hidrauliku (1) kërkohet për instalimin dhe lidhjen funksionale të dusheve me rrjetin e ujit, si dhe për testimin e tyre.

-Inxhinieri Gjeodet (1) siguron vendosjen e saktë të elementeve në terren sipas planvendosjes dhe kontrollon nivelimin dhe drejtëzimin e strukturave në një terren jo të qëndrueshëm si rëra.

-Shoferi (1) është i nevojshëm për transportin dhe shpërndarjen e elementëve në zonat përkatëse të plazhit.

-Saldatori (1) nevojitet për montimin dhe fiksimin e elementëve metalikë ndihmës (ankyra, lidhësa, baza), të domosdoshëm për stabilitetin e strukturave.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbeje autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zoterojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka rreth funksionit të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.3 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme për kryerjen e furnizimit, me qëllim realizimin e objektit të kontratës:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Kamionçine	1 copë
2	Makine prerese derrase Pantograf CNC	1 cope
3	Makineri laminimi(laminator)	1 cope
4	Makineri prerese metali me lazer ose ekuivalent	1 cope
5	Saldatriçe	1 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata ku të specifikohet afati i kontratës.

- Per mjetet e marra me qira qe shenohen ne regjistra publik, duhet te paraqitet dokumentin qe vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet qe nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti qe vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 9. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 40 pika 5/ç te VKM nr. 285, date 19.05.2021"Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar. Kërkesa për mjetet dhe pajisjet minimale justifikohet nga natyra e objektit të prokurimit, i cili konsiston kryesisht në transportin, montimin dhe instalimin në terren të strukturave të gatshme (pasarela, kabina, dushe, kulla vrojtimi dhe tabela informuese), në kushte specifike të terrenit ranor. Për realizimin korrekt dhe në kohë të këtij procesi, është e domosdoshme disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme, si më poshtë:-Kamionçina (1) është e nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e elementëve të gatshëm në zonat e plazhit, duke garantuar logjistikë të vazhdueshme gjatë procesit të montimit.-Makineria prerëse dërrase (Pantograf CNC) (1) kërkohet për realizimin e përshtatjeve dhe rregullimeve të sakta të elementeve drusore në terren, në rastet kur është e nevojshme përputhja me kushtet reale të vendosjes dhe lidhjet modulare të strukturave. -Makineria laminuese (laminator) (1) nevojitet për përfundimin dhe mbrojtjen e elementëve grafikë të tabelave informuese, duke siguruar rezistencë ndaj rrezeve UV, lagështisë dhe kripës detare në momentin e instalimit. -Makineria prerëse metali me lazer ose ekuivalent (1) kërkohet për përpunimin dhe përshtatjen e elementëve metalikë ndihmës (lidhësa, ankore, baza), në rastet kur është e nevojshme ndërhyrje për sigurimin e fiksimit dhe stabilitetit të strukturave në terren. -Saldatrici (1) nevojitet për realizimin e lidhjeve metalike dhe përforcimin e elementëve mbajtës, duke garantuar qëndrueshmëri dhe rezistencë të strukturave në kushtet e përdorimit në ambient detar. Këto mjete dhe pajisje minimale garantojnë që procesi i montimit dhe instalimit në terren të realizohet në përputhje me specifikimet teknike, në kushte sigurie dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë furnizimin, shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nga autoriteti kontraktor.Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojnë do të jenë sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe të marrin përsiper levrimin, shërbimin e transportit, montimin, si dhe vendosjen neper vende te te gjitha pajiseve ne perputhje me specifikimet. Dekolarata eshte deshmi qe verteton marrjen e pergjegjesive nga operatoret ekonomike dhe krijon nje besueshmeri dhe siguri per autoritetin, per furnizimin nw pwrputhje me specifikimet teknikin dhe transportimin e strukturavepranë vendeve të përcaktuara nga bashkia Durres.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, skica teknike, fletë teknike ose dokumentacion tjetër teknik nga prodhuesi, ku të evidentohen dimensionet, materialet si dhe karakteristikat teknike të çadrës së ofertuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Katalogu, skica teknike, fletë teknike ose dokumentacion tjetër teknik nga prodhuesi janë deshmi që verteton marrjen e përgjegjesive nga operatorët ekonomike dhe krijon një besueshmeri dhe siguri për autoritetin, për furnizimin e mallrave.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim për periudhën e garancisë së mobiljeve dhe pajisjeve për një periudhë 24 muaj (Aneksi nr.1).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e mallrave dhe mobiljeve, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë furnizimin me cilësi për mos të qënë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë mobiljet..

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si me poshte:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Dokumentacioni teknik, specifikimet teknike, preventivi me zerrat e mallrave janë pjesë e pandare e DST. Specifikimet teknike, shprehin qartë kërkesat e FSHZH dhe lidhen ngushtë me natyrën objekt kontrate.

Shënim: Per zerrat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

-Përpara se të shpall njoftimin paraprakt të fituesit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti

institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë të huaj duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe.